



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 18179 Prot

Tiranë, më 11.7.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

**DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

Kryetar i Degës Doganore Sarandë
Kategoria B, Kategoria e pagës III- a/1, (një vend)

Përshkrim përgjithësues për pozicionet:

Nëpunësit e kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

Ushtron funksionet dhe kompetencat sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për këtë pozicion, si dhe funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

Administron Degën Doganore në kryerjen e funksioneve të saj parësore, kryesisht atë të mbledhjes së të ardhurave si dhe lidhur me misionet e saj mbrojtës dhe ekonomik në përputhje me ligjin.

Miraton plane pune, grafikë shërbimesh etj si dhe kryen vleresimin e performancës së stafit nën varësinë e tij

Nxjerr akte administrative në lidhje me shkeljet e konstatuara në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore

Organizon në mënyrë eficiente punën në degën doganore, si dhe organizon kontrolle në të gjitha elementët e saj për të shmangur evazionin fiskal në fushën Doganore dhe atë të Akcizës.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Shkencor” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike, Politeknike, Juridike.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune, në pozicion të nivelit ekzekutiv ose të ulët drejtues.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 27 .7 .2019 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Fusha e Njohurive:

- 1.Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 2.Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.
4. Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronesine Industriale”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.

6. Ligji nr. 8874, datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

7. Ligji nr. 9367, datë 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar

8. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për miratimin e Rregullores së Brendshme “ Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:

9. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele, pastaj nëpunësve civilë për ngritje në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

